



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik - Municipality of Kaçanik



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës  
Sektori i Emergjencave



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	20.05.19	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	07		109/02-14934	7.

## PLANI I REAGIMIT EMERGJENT PËR KOMUNËN E KAÇANIKUT



<b>A. Hyrje</b>	
Objektivat e Planit: .....	4
Qëllimi i planit: .....	4
Përkufizimet .....	5
<b>B. Baza ligjore.....</b>	<b>6</b>
<b><u>I.PROFILI KOMUNAL.....</u></b>	<b>6</b>
<b><u>II. SEKTORI I EMERGJENCAVE.....</u></b>	<b>7</b>
<b>III. PLANET PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË HARTOHEN PËR FAZAT E PARANDALIMIT, REAGIMIT DHE RIMËKËMBJES AFATSHKURTËR.....</b>	<b>8</b>
<b>III.4.4.Plani i reagimit kombëtar dhe planet e reagimit emergjentë komunal, përmbajnë dokumente lidhur me: .....</b>	<b>9</b>
<b>III.5. Organizimin dhe mënyrën e zbatimit të mbrojtjes personale dhe reciproke të punëtorëve; .....</b>	<b>9</b>
<b>III.6. Objektet e Rëndësisë së Veçantë në Komunën e Kaçanikut.....</b>	<b>10</b>
<b>III.6.3. URAT NË RRUGËN MAGJISTRALË DHE RAJONALE.....</b>	<b>12</b>
<b>III.6.4. URAT NË RRUGËT LOKALE.....</b>	<b>13</b>
<b>III.6.5. URAT NË KOMUNIKACIONIN HEKURUDHOR.....</b>	<b>14</b>
<b>III.6.6. TUNELET NË RRUGËN MAGJISTRALË.....</b>	<b>15</b>
<b>III.6.7. TUNELET NË RRUGËN HEKURUDHORE.....</b>	<b>15</b>
<b>III.6.8. Stacionet e derivative.....</b>	<b>16</b>
<b>IV. Arsimi .....</b>	<b>17</b>
<b>IV.1. Struktura arsimore e popullsisë .....</b>	<b>17</b>
<b>IV.2. SHËNDETËSIA.....</b>	<b>19</b>
<b>IV.2.1.1.Struktura profesionale në QKMF, sipas profileve,.....</b>	<b>20</b>
<b>IV.2.2. Mjetet dhe mundësia e informimit dhe e alarmimit.....</b>	<b>21</b>
<b>IV.3. FURNIZIMI ME UJË.....</b>	<b>21</b>
<b>IV.3.1. Sistemi dhe kapaciteti i furnizimit me ujë.....</b>	<b>21</b>
<b>IV.4. Rrjeti energjetik.....</b>	<b>22</b>
<b>IV.5. Shërbimet e Internetit.....</b>	<b>22</b>
<b>IV.6.Shërbimet Postare .....</b>	<b>22</b>
<b>IV.7. Llojet e strehimoreve, kapacitetet e tyre dhe objektet tjera për strehim.....</b>	<b>23</b>
<b>V.GJENDJA AKTUALE E SHËRBIMEVE EMERGJENTE .....</b>	<b>24</b>
<b>V.1. Njësia Profesioniste e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit.....</b>	<b>24</b>

V.2. Lista e personelit sipas ndërrimeve dhe detyrave.....	25
V.3. Aktivizimi i planit të reagimit emergjent.....	25
V.3.1. Aktivizimi i alarmit, përgjegjësia për alarm dhe pasqyra e përfshirjes fillestare të incidentit .....	26
V.4. Faza e Përgjigjes kalon në këto etapa.....	27
V.5. Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Parandalimit dhe Lehtësimit.....	27
V.6. Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Parapërgatitjes dhe Mbrojtjes.....	27
V.7. Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë fazës së Përgjigjes.....	28
V.8. Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Rikthimit në Gjendjen Normale.....	28
VI. STRUKTURA E ORGANIZIMIT TË ZYRËS PËR ALARMIM.....	29
VI.1.1. Zyra për Alarmim dhe Koordinim Emergjent(ZAKE).....	29
VI.2. Detyrat e zyrës për alarmim dhe koordinim emergjent .....	30
VI.3. Komandanti i incidentit (KI).....	30
VI.4. Kompetencat e veçanta të KI.....	30
VI.4.2. Posti i komandës.....	31
VI.5. Pasqyra e subjekteve përgjegjëse për Reagim në raste Emergjente për Komunën e Kaçanikut.....	32
VII DETYRAT E EKIPEVE TË REAGIMIT EMERGJENTË (ERE).....	32
VII.1. Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (NJPZSh).....	32
VII.2. Policia e Kosovës.....	32
VII.3. Shërbimi Mjekësor i Emergjencës.....	33
VII.4. Forcat e Kosovës (KFOR-i).....	33
VII.5. Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK).....	33
VII.6. Shërbimet tjera.....	33
VII.6.1. Lista e resurseve humane dhe materiale e Biznesit privat në kuadër të komunës .....	34
VII.7. Zingjiri komandues.....	35
VII.7.1. Komunikimi me publikun.....	35
VII.7.2. Komunikimi dhe ndërlidhjet.....	35
VII.7.3. Njësit për Reagim Emergjent.....	35
VII.8. PASQYRA E EKIPEVE DHE PERSONELIT PËR REAGIM EMERGJENT.....	36
VII.8.1 Njësitë profesionale të zjarrfikësve dhe shpëtimit .....	36
VII.8.2. Njësitet e policisë .....	36
VII.8.3. Shërbimet mjekësore emergjente .....	36
VII.8.4. Trupat e FSK-së.....	37
VII.8.5. KFOR-i.....	37

<b>VIII .PËRGJEGJËSIA KRYESORE DHE SUAZAT E PËRGJEGJËSISË PËR T'IU PËRGJIGJUR VEPRIMEVE.....</b>	<b>37</b>
VIII.2. Detyrat dhe Roli i Komitetit për Reagim Emergjent .....	37
VIII.2.1. Agjencitë dhe organizatat të aktivizuara në përballimin e fatkeqësive.....	38
VIII.2.2. KOMITETI I REAGIMIT EMERGJENT NË KOMUNËN E KAÇANIKUT.....	39
<b>IX.MENAXHIMI I RESURSEVE GJATË NJË INCIDENTI .....</b>	<b>40</b>
IX.1. Identifikimi i nevojave.....	40
IX.2. Porositja dhe sigurimi.....	41
IX.3. Përcjellja dhe raportimi.....	41
IX.4. Mobilizimi .....	41
IX.5. Rimëkëmbja dhe demobilizimi.....	41
IX.5.1. Resurset jo të harxhueshme.....	41
IX.5.2. Resurset e harxhueshme .....	41
IX.6. Kompensimi .....	41
IX.7. Inventarizimi.....	41
IX.8. Porositja dhe sigurimi.....	41

## A. HYRJE

Me Planin e Reagimit Emergjent të Komunës së Kaçanikut për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë e tjera nënkuptojmë përcaktimin e kapaciteteve dhe resurseve si dhe caktimin e përgjegjësive, proceset operative për të ndihmuar mbrojtjen e vendit nga rreziqet natyrore, teknologjike të shkaktuara nga faktori njeri; shpëtimin e jetëve; mbrojtjen e shëndetit publik, sigurinë, të mirat materiale dhe mjedisin. Përfundimisht, Plani i Reagimit Emergjent i komunës shërben për t'i zbatuar në mënyrë më efektive dhe më efikase aktivitetet e menaxhimit të incidenteve, në kontekst të llojeve të veçanta të incidenteve.

Rreziqet në shumtën e rasteve kanë ndodhur, ose kanë ardhur në befasi dhe pa paralajmërim që do të thotë se fatkeqësitë sulmojnë të gjithë, në çdo kohë dhe kudo.

Fatkeqësitë nuk zgjedhin kohën as vendin se ku do të ndodhin. Andaj të gjithë jemi të kërcënuar nga rreziqet e ndryshme që i kërcënojnë interesat e sigurisë në çdo kohë dhe në çdo vend.

Mënyra më e mirë për tu mbrojtur për situata të tilla është vlerësimi, planifikimi dhe programimi i veprimtimit të menduar për emergjencën duke udhëzuar kur veprimet emergjente janë të nevojshme.

Kërcënim për rrezikshmëri me përmasa të mëdha apo të vogla, mund të jetë çdo dukuri e shkaktuar nga vetë natyra ose nga ndikimi i njeriut, çdo proces ose çdo ngjarje me të cilën shkaktohet humbje në njerëz apo të mirave materiale, si:

- **infrastrukturë, ambient,**
- **trashëgimi kulturore,**
- **shkatërrim i ekonomisë industriale**
- **dhe bujqësore.**

### **Objektivat e Planit:**

Vlerësimi i rrezikut;

Masat parandaluese, (zbutja e efekteve të rreziqeve)

Reagimi Emergjent

Menaxhimi i Resurseve

Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve;

Mbrojtja dhe ruajtja e pasurisë dhe të mirave materiale;

Ruajtja dhe mbrojtja e ambientit.

### **Qëllimi i planit:**

**Plani i Reagimit Emergjent**, nënkupton dokumentin për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësish të tjera, i hartuar në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë dhe të dokumenteve të tjera për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.<sup>1</sup>

Qëllimi i hartimit të këtij Plani është krijimi i prioritetëve për një koordinim sa më efikas në mes të subjekteve relevante të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rastet e fatkeqësive natyrore siç janë: vërshimet, rrëshqitjet e dheut tërmetet, zjarret, dëborat ngricat etj.

Koordinimi i veprimeve (në raste të zjarreve me përmasa të mëdha) të Njesisë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (NjPZSh) të Komunës së Kaçanikut me NjPZSh-ët e komunave fqinje dhe Agjencionin Pyjor Rajonal të Kosovës.

<sup>1</sup> Neni 3 paragrafi 1.3. Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

## Përkufizimet

**Emergjencë.** Çdo ndodhi për të cilën është e nevojshme ndihma qendrore për plotësimin e kapaciteteve dhe përpjekjeve regjionale dhe lokale për shpëtimin e jetëve, mbrojtjen e të mirave materiale dhe shëndetit publik apo për zvogëlimin ose shmangien e rrezikut të katastrofës në çdo pjesë të Republikës së Kosovës

**Fatkeqësi natyrore** – janë: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortek, erë e fuqishme, breshër, borë me shi, acar, thatësi, zjarr fushor, shpërthim i sëmundjeve infektive që ndikojnë në njerëz, kafshë ose bimë dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore;

**Fatkeqësi tjera** – janë: aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidentet nukleare dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, lufta dhe gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste me mjete klasike dhe forma tjera të dhunës në masë

**Reagues i parë.** Personel lokal qeveritar dhe joqeveritar i policisë, zjarrfikjes dhe emergjencave të cilët në fazat e hershme të një incidenti janë përgjegjës për mbrojtjen dhe ruajtjen e jetës, të mirave materiale, provave dhe mjedisit, përfshirë personelin e menaxhimit emergjent, shëndetit publik, kujdesit spitalor, punëve publike dhe personelin tjetër me përvojë, të cilët ofrojnë shërbime të menjëhershme mbështetëse gjatë operacioneve të parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes. Në reaguesit e parë mund të përfshihet personeli i strukturave qendrore, regjionale, lokale apo i atyre joqeveritare.

**Komandanti i Incidentit (KI).** Person përgjegjës për të gjitha aktivitetet në incident, përfshirë zhvillimin e strategjive dhe taktikave si dhe porositjen dhe lirimimin e resurseve. KI ka përgjegjësinë dhe autoritetin e plotë për zhvillimin e operacioneve në incident dhe është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha operacioneve në vendin e ngjarjes.

**Reagimi Emergjent** – aktivitetet të cilat adresojnë efektet e shpejta dhe të drejtpërdrejta të një incidenti, duke i përfshirë veprimet e menjëhershme për ruajtjen e jetës, të mirave materiale dhe mjedisit, plotësimin e nevojave elementare njerëzore si dhe mirëmbajtjen e strukturës sociale, ekonomike dhe politike të komunitetit të goditur

**Resurset për mbrojtje** - shpëtim dhe ndihmë - të gjitha burimet njerëzore, teknike, materiale dhe financiare, duke përfshirë mjetet dhe pajisjet për mbrojtje dhe shpëtim, objektet e strehimit dhe mjetet tjera të mbrojtjes, mjetet dhe pajisjet për trajnim, depot, mjetet e transportit, mjetet për komunikim dhe njoftim, të destinuara për tu përdorur apo të përdorura në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;<sup>2</sup>

**Plani veprues për incidentin.** Një plan gojor apo i shkruar i cili përmban në vete objektivat e përgjithshme, të cilat reflektojnë strategjinë e përgjithshme për menaxhimin e incidentit. Mund të përfshijë përcaktimin e detyrave dhe resurseve operative.

<sup>2</sup> Përkufizimet e marrura nga Neni 3 i Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera

## B. Baza ligjore

Ky „Plan i Reagimit Emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera “ për territorin e komunës së Kaçanikut del nga :


- a) Ligji Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera
- b) Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri,
- c) Ligji Nr.04/L-049 për zjarrfikje dhe shpëtim,
- d) Plani i Reagimit Kombëtar,
- e) Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave - SIME
- f) Rregullore nr. 08/2013 për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent, si dhe ligjeve tjera që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me emergjencat civile, nisur dhe nga përvoja e krijuar për përballimin e emergjencave civile në vitet e fundit.

## I. PROFILI KOMUNAL

I.1. Komuna e Kaçanikut shtrihet në pjesën Jugore, të Kosovës, përafërsisht në gjerësinë gjeografike  $42^{\circ} 13' 40''$  dhe gjatësinë gjeografike  $21^{\circ} 15' 31''$ . Ka sipërfaqe rreth  $210.90 \text{ km}^2$  dhe 33.409 banorë sipas regjistrimit të vitit 2011<sup>3</sup>.

Komuna kufizohet me komunën e Ferizajit në veri, Vitinë në verilindje, Shtërpcën në perëndim dhe Hanin e Elezit në jug. Gjatësia e vijës totale kufitare është 101.41km dhe kryesisht është territor malor.

**Harta:1.** – Kufizimi i komunës së Kaçanikut dhe gjatësia e vijës kufitare



<sup>3</sup>Shenimet e marra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës 2011

Distanca më e largët në territorin e komunës është 22,3 km në mes fshatrave Sllatinë në perëndim dhe Korbliq në lindje. Në drejtim veri-jug dallimet nuk janë aq të theksuara. Forma e sipërfaqes së komunës nuk ka ndonjë formë të rregullt por është mjaft e thyer, relievi i shprehur malorë ndikon në shtrirjen e rrugëve dhe vështirëson lidhjen e vendbanimeve me qendrën komunale. Për shkak të lidhjeve komunikative, disa fshatra shërbimet e tyre i përmbushin në qendrat për rreth që janë më afër, ndërsa me qendrën komunale komunikojnë vetëm për çështje administrative

**Tabela :1.** Gjatësia e vijës kufitare në komunën e Kaçanikut

Kufizimi me komunën, shtetin	Gjatësia	Përqindja
Ferizaj	20,05	19.77
Vitia	27,10	26.72
Maqedonia JL	6,62	6,52
Hani i Elezit	23,34	23,00
Maqedonia JP	11,42	11,26
Shtërpca	12,88	12.74
Gjithsej	101.41	100

## II. SEKTORI I EMERGJENCAVE

**II.1.** Në sferën e emergjencës bashkëpunimi bëhet me: organizatat joqeveritare-institucionet shëndetësore, lokalitetet urbane dhe rurale në rastet e fatkeqësive elementare, zjarreve, vërshimeve, tërmeteve si dhe në rastet tjera ku paraqitet nevoja.

**II.1.2.** Bënë vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë në komunë dhe njëkohësisht ndërmerr masat preventive për parandalimin dhe evitimin e rrezikshmërisë.

**II.1.3.** Bënë njoftimin dhe paralajmërimin e qytetarëve për rrezikun e pashmangshëm dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

**II.1.4.** Bënë njoftimin dhe aktivizimin e personave që kryejnë detyra të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës për rrezikun;

**II.1.5.** Bënë Koordinimin me strukturat përgjegjëse në Komunë (Policinë e Kosovës, KFOR-in, FSK-në dhe Shërbimin Shëndetësorë);

**II.1.6.** Bënë zbulimin, monitorimin dhe hulumtimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

**II.1.7.** Bënë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

**II.1.8.** Bënë përcaktimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse;

**II.1.9.** Bënë rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera deri te sigurimi i kushteve elementare për jetë;

**II.1.10.** Bënë parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

### III. PLANET PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË HARTOHEN PËR FAZAT E PARANDALIMIT, REAGIMIT DHE RIMËKËMBJES AFATSHKURTËR

**III.1. Parandalimit** - mbrojtjes preventive;

**III.2. Reagimit** - veprimet në rastet e kërcënimeve të pashmangshme nga rreziqet dhe gjatë tyre, përkatësisht shpëtimit të njerëzve të prekur, të mirave materiale, kulturore dhe të mjedisit, si dhe zbutjes së pasojave të shkaktuara;

**III.3. Rimëkëmbjes afatshkurtër**- mënjanimi të pasojave të shkaktuara dhe krijimit të kushteve për normalizimin e jetës në zonën e goditur.<sup>4</sup>

Planet hartohen në bazë të dokumentit „Vlerësimi i Rrezikshmërisë“ nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

**III.4. Në plane përcaktohen masat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë si në vijim:**

**III.4.1.** Në fazën e **parandalimit** përcaktohen masat preventive për mbrojtje nga rreziqet që mund të paraqiten :

- Rregullimi hapësinor dhe ndërtimi i objekteve që janë në funksion të mbrojtjes dhe shpëtimit;
- Zbatimi i normave të ndërtimit;
- Ndërtimi i objekteve për mbrojtje nga rrëshqitjet;
- Ndërtimi i objekteve për mbrojtje nga vërshimet;
- Rregullimi i përroskave, lumenjve, përroskave vërshuese, ndërtimi i mureve përforcues;
- Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse tek njerëzit, kafshët dhe bimët;
- Masat e mbrojtjes nga zjarri;
- Vendosja e sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit, ku përfshihen:
- Organizimi i vrojtimit dhe monitorimit të ngjarjeve që mund të nxisin fatkeqësi;
- Njoftimi me kohë i qytetarëve dhe institucioneve përgjegjëse për rrezikun nga ato fatkeqësi;
- Veprimet e qytetarëve dhe institucioneve përgjegjëse për pengimin e ndodhjes së fatkeqësive;
- Masat tjera të cilat mund të ndikojnë në pengimin e ndodhjes së fatkeqësive ose zbutjen e ndikimit të tyre;
- Aftësimi dhe sigurimi i mjeteve materiale dhe resurseve tjera të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara dhe masave tjera.

**III.4.2. Për fazën e reagimit** përcaktohen ato masa të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës me të cilat bëhet shpëtimi i menjëhershëm i njerëzve të rrezikuar, të mirave materiale, kulturore dhe mjedisit dhe me të cilat ndikohet në zvogëlimin apo pengimin e përhapjes së pasojave.

Këto masa janë:

- Organizimi i udhëheqjes dhe koordinimit të veprimeve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
- Angazhimi i strukturave operative dhe sipas nevojës angazhimi i numrit të nevojshëm të njerëzve dhe mjeteve materiale të institucioneve, ndërmarrjeve dhe personave juridik;
- Ofrimi i ndihmës së parë mjekësore për të lënduarit apo të sëmurit; evakuimi i qytetarëve të rrezikuar dhe të goditur;
- Pranimi, strehimi dhe kujdesi ndaj njerëzve dhe zhvendosja e të mirave materiale; Mbrojtja dhe shpëtimi i kafshëve dhe ushqimit të tyre;
- Shpëtimi nga rrënojat, vërshimet, zjarret, shpërthimet nukleare radiologjike, incidentet kimike biologjike;
- Mbrojtja dhe shpëtimi i bimëve dhe produkteve bimore;

<sup>4</sup> Rregullore nr. 08/2013 për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent , Neni 4 – Hartimi i Planeve

**III.4.3. Për fazën e rimëkëmbjes** afatshkurtër planifikohen ato masa të mbrojtjes dhe shpëtimit, me të cilat sigurohen kushtet elementare për jetë dhe punë në zonën e prekur.

4.3.1. Këto masa janë:

- Aftësimi i objekteve të banimit dhe objekteve tjera për përdorim;
- Sanimi i terrenit dhe burimeve të ujit të pijshëm;
- Organizimi, grumbullimi dhe shpërndarja e ndihmave; . Zbatimi i masave të mbrojtjes shëndetësore dhe higjieno-epidemike;
- Grumbullimi i të dhënave për pasojat e shkaktuara në njerëz, të mira materiale, kulturore dhe mjedisore;
- Përcaktimi dhe vlerësimi i dëmeve të shkaktuara dhe zbatimi i masave tjera.<sup>5</sup>

**III.4.4. Plani i reagimit kombëtar dhe planet e reagimit emergjentë komunal, përmbajnë dokumente lidhur me:**

- Masat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- Strukturat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
- Resurset njerëzore, mjetet materiale dhe teknike të cilat mund të angazhohen për plotësimin e strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
- Mënyrën e zbatimit të gatishmërisë dhe mënyrën e mobilizimit të strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
- Përgjegjësitë dhe autorizimet në menaxhimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
- Veprimin e strukturave të mbrojtjes, shpëtimit, ndihmës dhe pjesëmarrësve të tjerë në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- Mënyrën e mbajtjes së rendit dhe sigurisë gjatë reagimit;
- Mënyrën e evitimit të pasojave të rreziqeve;
- Mënyrën e sigurimit të mjeteve financiare për zbatimin e planeve;
- Mënyrën e informimit të qytetarëve dhe publikut;
- Mënyrën e pranimit dhe ofrimit të ndihmës në mbrojtje dhe shpëtim nga komunat apo shtete tjera;
- Hartat topografike; dhe
- Dokumentet tjera të nevojshme për lehtësimin e zbatimit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.<sup>6</sup>

Me planet e reagimit emergjent rregullohet organizimi dhe mënyra e realizimit të mbrojtjes dhe shpëtimit të punëtorëve, të mirave materiale dhe kulturore të institucioneve, ndërmarrjeve dhe organizatave tjera nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe mënyra e zbatimit të detyrave të cilat caktohen për ta në planet operative emergjente komunale, përkatësisht në planin e reagimit kombëtar<sup>7</sup>

**III.5. Organizimin dhe mënyrën e zbatimit të mbrojtjes personale dhe reciproke të punëtorëve;**

**III.5.1.** Pasqyrën e strukturës së institucioneve, ndërmarrjeve dhe organizatave tjera me të dhënat për punëtorët, pajisjet dhe mjetet materialo-teknike të cilat do t'i përdor struktura e lartcekur në zbatimin e detyrave të saj;

<sup>5</sup> Rregullore nr. 08/2013 për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent , neni 5 paragrafi 6

<sup>6</sup> Rregullore nr. 08/2013 për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent , Neni 7 -Planet e nivelit qendror dhe local paragrafi 1.2 Masat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë

<sup>7</sup> Rregullore nr. 08/2013 për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent , Neni 22

- III.5.2.Mënyrën e realizimit të bashkëpunimit me ministrinë, agjencinë, institucionet kompetente komunale dhe strukturat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
- III.5.3.Mënyrën e zbatimit të detyrave që janë të rëndësishme për mbrojtje dhe shpëtim;
- III.5.4.Mënyrën e njoftimit dhe alarmimit;
- III.5.5.Mënyrën e evakuimit;
- III.5.6.Strehimin (për institucionin, ndërmarrjen dhe organizatën në objektin e të cilit gjendet strehimorja);
- III.5.7.Mënyrën e njoftimit të qendrës përkatëse 112;
- III.5.8.Pasqyrën e personave përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, aktivizimin dhe angazhimin e tyre për secilën masë të planifikuar; dhe
- III.5.9.Pasqyrën e strukturave tjera të mbrojtjes dhe shpëtimit me të dhënat për udhëheqësit e tyre, adresat e tyre dhe numrat e telefonit, me qëllim të realizimit të bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke.

### **III.6. Objektet e Rëndësisë së Veçantë në Komunën e Kaçanikut**

#### **III.6.1. Institucionet Publike**

1. **Kuvendi i Komunës**
2. **Policia e Kosovës**
3. **Shtëpia e Shëndetit – Ambulanca**
4. **Shërbimi i Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit - SHZSH**
5. Shtëpia e Kulturës "Xheladin Kurtaj"
6. Ndërtesa e **Gjykatës Komunale**
7. **Posta** e Kaçanikut
8. Gjimnazi "Skenderbeu"
9. Shkolla e Mesme Profesionale "Vëllezërit Çaka dhe Feriz Guri"
10. Shkolla fillore "Emin Duraku"
11. Shkolla fillore "Idriz Seferi"
12. Qendra e Arsimit Parashkollor "Agimi"
13. Ish Shtëpia e mallrave "Sharri"
14. **Ish Kazerma e TMK-së (Sanatoriumi)**
15. Ish Motel "Kalaja"
16. Stacioni i Trenave

#### **III.6.2. Objekte Biznesi**

1. SH.P.K "NEW LEPENCI" - Qenan Idrizi - Kaçanik
2. SH.P.K." SILKAPOR" - Zelqif Berisha - Matlumë
3. SH.P.K. " KIVO". - Visar Ramajli - K. i Vjetër
4. N..P " X – FORT " - Sali Selmani - Doganaj
5. SH.P.K." SANKOS " - Shefqet Neziri - Kaçanik
6. N.P. " EUROTHESI " - Blerim Zenuni - Doganaj
7. SH.P.K. "KEMA" - Arsim Kolshi - Doganaj

III.6.3. URAT NË RRUGËN MAGJISTRALË DHE RAJONALE

Emri /numri	Kapaciteti bartës	Lokacioni adresa	Lokacioni koordinatat	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	Gjendja	Rreziku	Shënim
Ura në Magjistrale	50t	Fusha e Pajtimit	Y=7517335.035 X=4682447.604	24m	8.5m	4m	E mirë	I kufizuar	
Ura në Magjistrale Në hyrje të Kaçanikut	50t	Në hyrje të Kaçanikut (te vorrezat e qytetit)	Y=7520998.136 X=4676784.952	35m	8.5m	4m	E mirë	I kufizuar	E renovuar nga KFOR-i
Ura në Magjistrale mbi Lumin Lepenc	50t	Kaçanik në Magjistrale mbi Lumin Lepenc	Y=7520956.956 X=4676583.882	95m	8.5m	7m	E mirë	I kufizuar	E renovuar nga KFOR-i
Ura te Guri i Shpumë Në rr. magjistrale Kaçanik- H. Elezit	50t	Kaçanik në Magjistrale mbi Lumin Lepenc	Y=7521121.268 X=4676784.799	165m	9.5m	7m	E mirë	I kufizuar	E ndërtuar nga KFOR-i
Ura në Kriva Rekë Në rr. magjistrale Kaçanik- H. Elezit	50t	Kaçanik mbi përroit e Kriva Rekës	Y=7521001.625 X=4674264.229	140m	9.5m	30m	E mirë	I kufizuar	E renovuar nga KFOR-i
Ura në Kashan Në rr. magjistrale Kaçanik- H. Elezit	50t	Gjyrgjedell Mbi përroit e Kshanit	Y=7522413.435 X=4670660.282	210m	9.5m	20m	E mirë	I kufizuar	Gjysma e urës gjendet në territorin e Hanit të Elezit
<b>Urat në rrugën Rajonale në drejtim të pikës Kufitare në Gilloboçicë</b>									
Ura mbi lumin Lepenc.Rr. rajonale Kaçan.- Gilloboçicë	50t	Fsh. Doganaj Rruga për Gilloboçicë	Y =7514886.644 X=4680824.473	55m	8.5m	6m	E mirë	I kufizuar	
Ura për te stanet e Doganajve	50t	Dubravë - Vataj	Y=7514041.714 X=4677547.403	30m	8.5m	4m	E mirë	I kufizuar	
Ura mbi përroit Reka e kafegjisë	50t	Rruga për te Burimi i Ujit	Y=7514823.899 X=4675787.609	50m	8.5m	4m	E mirë	I kufizuar	
Ura në rrugën rajonale për Gillob.	50t	Në hyrje të tunelit Gillob.	Y=7514188.183 X=4673586.236	50m	8.5m	4m	E mirë	I kufizuar	
Ura në rrugën rajonale për Gillob.	50t	Në dalje të tunelit Gillob.	Y=7514196.443 X=4673477.176	55m	8.5m	4m	E mirë	I kufizuar	

### III.6.4. URAT NË RRUGËT LOKALE

Emri /numri	Kapaciteti bartës	Lokacioni adresa	Lokacioni koordinatat	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	Gjendja	Rreziku	Shënim
“Ura e Konakut” mbi lum. Nerod.	40t	Kaçanik Rr. “A. Bajrami”	Y=7521197.916 X=4676504.142	25m	6.5m	3m	E mirë	I kufizuar	Ura e vjetër
Ura e re mbi lum. Nerod.	50t	Kaçanik Rr. “A. Bajrami”	Y=7521195.816 X=4676544.532	25m	8.5m	3m	E mirë	I kufizuar	E ndërtuar me donacion nga USAID me 2010
“Ura e Hazirit” mbi lum. Nerod.	30t	Kaçanik Bulevardi “I. Raka	Y=7521099.313 X=4677184.827	25m	3m	3m	E mirë	I kufizuar	E ndërtuar nga Hazir Jaha
Ura e Germanit Mbi lum. Lepenc	30t	Kaçanik Rr. “Vllazërit Çalka”	Y=7520991.503 X=4676564.690	43m	6.50m	4m	E mirë	I kufizuar	E ndërtuar me donacion nga USAID
Ura mbi lum. Lepenc	12t	Kovaqec (te seperacioni)	Y=7519828.173 X=4677928.212	30m	3m	4m	E dobët	I kufizuar	Nuk është e mirëmbajtur
Ura mbi lum. Lepenc	30t	Rruga për në fsh. Dubravë	Y=7517800.151 X=4680814.367	25m	6m	4m	E mirë	I kufizuar	
Ura mbi lum. Lepenc	6t	Fshatin Sllatinë	Y=7514502.951 X=4680814.367	25m	2.5m	4m	E dobët	Mesatar	I ndërtuar nga vetë banorët
Ura mbi lum. Nerodime	30t	Kaçanik i Vjetër Afër Hekurdhës	Y=7518917.465 X=4684553.172	15m	3m	3m	E mirë	I kufizuar	

### III.6.5. URAT NË KOMUNIKACIONIN HEKURUDHOR

Emri /numri	Kapaciteti bartës	Lokacioni adresa	Lokacioni koordinatat	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	Gjendja	Rreziku	Shënim
Ura mbi lumin Nerodime	60t	Fsh. Stagovë	Y=7521016.340 X=4680502.050	25m	5.8m	3.5m	E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi lumin Nerodime	60t	Fsh. Runjevë	Y=7520984.160 X=4679544.060	35m	5.8m	3.5m	E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi lumin Nerodime	60t	(Xhamija e Dëshmorëve)	Y=7521019.140 X=4677760.010	25m	5.8m	3.5m	E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi Lumin Lepenc	60t	Kaçanik në hyrje të fabrikës së gëlqerës	Y=7521181.357 X=4676252.888	40m	5.8m	3.5m	E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi Lumin Lepenc	60t	në dalje të fabrikës së gëlqerës	Y=7521153.124 X=4675920.459	40m	5.8m	3.5m	E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi Lumin Lepenc	60t	Kaçanik - te Teqja	Y=7521136.690 X=4675844.680	40m	5.8m	3.5m	E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi Lumin Lepenc Te Guri i Shpumë	60t	Kaçanik në hyrje të Tunelit	Y=7521199.830 X=4675443.020	40m	5.8m	3.5m	E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi Lumin Lepenc	60t	Kaçanik në dalje të Tunelit	Y=7521068.540 X=4675244.090	60m	5.8m	3.5m	E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi Lumin Lepenc- Gajre	60t	Në hyrje të tunelit të Gajrës	Y=7520697.590 X=4675012.430	40m	5.8m	3.5m	E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi Lumin Lepenc	60t	Në dalje të Tunelit të Gajrës	Y=7520603.050 X=4674705.626	40m	5.8m	3.5m	E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi Lumin Lepenc	60t	te Kulla e Qeshmës	Y=7520635.840 X=4674591.326	80m	5.8m		E mirë	I Kufizuar	
Ura mbi Lumin Lepenc	60t	Ura e Djegur te Kulla e Qeshmës	Y=7520854.970 X=4674354.246	80m	5.8m		E mirë	I Kufizuar	

### III.6.6. TUNELET NË RRUGËN MAGJISTRALË

Emri/numri	Lokacioni/ adresa	Lokacioni koordinatat	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	Gjendja	Rreziku	Shënim
Në rrugën rajonale Gllloboçicë	Gllloboçicë	Y=7514189.744 X=4673555.487	55m	9m	6.20m	E mirë	I kufizuar	
Në rrugën Magjistrale	Guri i Shpum-(Kriva Rekë)	Y=7520779.075 X=4674630.175	144m	9m	6.20m	E mirë	I kufizuar	
Në rrugën Magjistrale	Kashan	Y=7522008.421 X=4670945.539	170m	9m	6.20m	E mirë	I kufizuar	

### III.6.7. TUNELET NË RRUGËN HEKURUDHORE

Emri/numri	Lokacioni/ adresa	Lokacioni koordinatat	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	Gjendja	Rreziku	Shënim
Tuneli 1.	Në hyrje të fsh. Stagovë	Y=7520052.070 X=4682361.329	90m	5.20m	6.30m	E mirë	I kufizuar	
Tuneli 2.	Në fsh. Runjevë	Y=7520956.470 X=4679639.729	130m	5.20m	6.30m	E mirë	I kufizuar	
Tuneli 3.	Në hyrje te Guri i Shpumë	Y=7521195.004 X=4675412.287	90m	5.20	6.30m	E mirë	I kufizuar	
Tuneli 4.	Tuneli i Gajrës	Y=7520665.804 X=4674942.587	203m	5.20m	6.30m	E mirë	I kufizuar	
Tuneli 5.	Te Kulla e Qeshmës	Y=7521998.998 X=4671983.765	70m	5.20m	6.30m	E mirë	I kufizuar	
Tuneli 6.	Te Laçtë	Y=7521953.070 X=4670848.330	250m	5.20m	6.30m	E mirë	I kufizuar	
Tuneli 7.	Kashan	Y=7522179.675 X=4670623.329	110m	5.20m	6.30m	E mirë	I kufizuar	



**Foto:** Masat parandaluese nga rrëshqitja e dheut përgjatë Autostradës “Arbër Xhaferi” në fsh. Gajre.



**Foto:** Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc dhe ujëmbledhësve përgjatë autostradës “Arbër Xhaferi”

**Vërejtje:** Gjatë ndërtimit të Autostradës “Arbër Xhaferi” janë marrë masa për parandalimin e rrëshqitjeve të dheut dhe vërshimeve nga prurjet e të reshurave atmosferike duke ndërtuar ujëmbledhës për të zvogëluar rrezikun që mund të paraqitet gjatë të reshurave atmosferike. Ura në Autostradën “Arbër Xhaferi” nga fsh. Gajre deri në Hanë të Elezit (deri te Uji i Thartë) ka gjatësinë 7.420m.

- **Tunelet në komunikacionin rrugor**

Gjithsejtë tunele janë të 8, dy tunele janë në rrugën magjistrale Prishtinë -Shkup (tuneli në komunën kadastrale të Kaçanikut me gjatësi prej 144m dhe tuneli në komunën kadastrale të Gjyrgjedellit me gjatësi prej 170m), një në rrugën rajonale Kaçanik –Tetovë (tuneli në komunën kadastrale të Glloboshicës me gjatësi prej 60m)

- **Urat në komunikacionin hekurudhor**

– Në rrjetin hekurudhor të zonës urbane të Kaçanikut janë të ndërtuara gjithsejtë 12 ura. Prej gjithsejtë 12 urave mbi rrjetin hekurudhor, 9 janë të ndërtuar mbi lumin Lepenc dhe 3 mbi lumin Nerodime-s. Urat më të rëndësishme mbi rrjetin hekurudhor janë ato të ndërtuara mbi lumin Lepenc të cilat kanë gjatësi prej 10 deri në 70m.

- **Tunelet në komunikacionin hekurudhor**

– Një ndër karakteristikat e hekurudhës që kalon në komunën e Kaçanikut janë edhe tunelet që datojnë nga viti 1892 kur dhe është ndërtuar hekurudha. Në territorin e komunës së Kaçanikut janë gjithsej 5 tunele që janë të ndërtuara në rrjetin hekurudhor (tuneli më i gjatë në rrjetin hekurudhorë është ai në komunën kadastrale të Gjyrgjedellit me gjatësi prej 266m, pastaj në komunën kadastrale të Bob-it me gjatësi prej 198m, ai në kufirin mes komunës kadastrale të Runjevës dhe Stagovës me gjatësi prej 151m, tunelet e tjera kanë gjatësi prej 110 deri në 120m).

### III.6.8. Stacionet e derivative

Pompat dhe deponitë e Karburanteve në Komunën e Kaçanikut

KOSOVA	PETROL	Kapaciteti i Depos	250.000 LITRA – Magjistrale
INEX	PETROL	Kapaciteti i Depos	250.000 LITRA – Magjistrale
BUJAR & FILIX	PETROL	Kapaciteti i Depos	200.000 LITRA – Magjistrale
BUBEARI	PETROL	Kapaciteti i Depos	200.000 LITRA – Magjistrale
BALLKAN	PETROL	Kapaciteti i Depos	300.000 LITRA – Magjistrale
SHKËNDIA	PETROL	Kapaciteti i Depos	200.000 LITRA - Fushë pajtim
LIRIA	PETROL	Kapaciteti i Depos	90.000 LITRA – Duraj
VATA	PETROL	Kapaciteti i Depos	90.000 LITRA – Vataj
LINDI	PETROL	Kapaciteti i Depos	90.000 LITRA – Begracë
VEDA	PETROL	Kapaciteti i Depos	90.000 LITRA - Begracë
HETA	PETROL	Kapaciteti i Depos	90.000 LITRA – Begracë
BUBEARI	PETROL	Kapaciteti i Depos	90.000 LITRA – Nikaj
ALK- OIL DEPONI		Kapaciteti i Depos	4.000.000 LITRA – Gurëz

## IV.Arsimi

. Gjatë periudhës 90 - 99, shqiptarët organizojnë sistemin paralel të arsimit në Kosovë ku në mënyrë mjaft të mirë e ruajtën arsimin nga asimilimi i gjithmbarshëm i shoqërisë Kosovare. Lufta e fundit në Kosovë la pasoja të mëdha në infrastrukturën shkollore, këto dëme nuk kishin lënë pa prekur asnjë komunë me popullsi shqiptare në këtë rast edhe vetë komunën e Kaçanikut.

Në vitin 2002, krijuan një model të ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e re ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të ulët të mesëm dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të lartë të mesëm. Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re arsimit i obligueshëm është zgjatuar për një vit nga 8 vite sa ishte në 9 vite.

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Kaçanikut është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (5 - 6 vjeçar), arsimin fillor ( I - V ), arsimin e mesëm të ulët (VI - IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (X - XII).

Numri i objekteve shkollore gjithsejtë është 31, duke përfshi edhe çerdhen dhe shkollat e mesme. Nga të gjitha shkollat fillore 12 prej tyre janë amë dhe 16 të tjera janë satelite (paralele të ndara), 2 shkolla të mesme dhe një çerdhe. Në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar 578 punëtor. Prej tyre 488 mësimdhënës dhe 22 punëtor administrativ dhe 68 punëtor teknik. Numri i nxënësve gjithsejtë 6723,.

### IV.1. Struktura arsimore e popullsisë

Rreth 35 % e popullsisë së përgjithshme të komunës janë me shkollim fillore, ndërsa me shkollim të mesëm kemi rreth 31 %, me shkollim të lartë dhe me fakultete kemi rreth 5 % dhe ata me shkollim superior që marrin pjesë me 0.2 %. Element mjaft shqetësues mbetet pjesëmarrja e lartë e popullsisë pa shkollim fare (pa shkollë fillore) që përfshinë 10.2 % të popullsisë së gjithmbarshme të komunës

**Tabela:** Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit, njohjes së shkrim leximit <sup>8</sup>

NIVELI ARSIMOR												
Nuk ka arsim formal		Fillor		I mesëm i ulët		I mesëm i Lartë		Shkolla e lartë	Fakulteti( baqelor)	Pas univerzitare	Doktoraturë	Gjithësej
Din shkrim lexim	Nuk din shkrim lexim	4 klasë system i vjetër	5 klasë system i ri	8 klasë system i vjetër	9 klasë system i ri	12 klasë system I vjetër	13 klasë system I ri					
1.346	985	1.731	2.691	6.814	3.007	6.622	2.591	472	892	72	5	27.228

<sup>8</sup>Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit, njohjes së shkrim leximit -Shenimet e marra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës 2011 (ask)

Tabela:

Niveli	Emri	Lokacioni/ adresa	Mësimdhënës	Nxënës	Gjithësej
I Mesëm	Gjimnazi "Skenderbeu"	Kaçanik	46	804	850
I Mesëm	SHMP"Feriz Guri dhe Vllezërit Çaka"	Kaçanik Rr."Vllezërit Çaka"	56	757	813
fillor	"Emin Duraku"	Kaçanik Rr. "S. Bajra"	82	1500	1582
fillor	"Nazmi Osmani"	Fsh. Elezaj	27	347	374
fillor	"Qamil Ilazi"	K. I Vjetër	24	411	435
fillor	"7Shtatori"	Begracë	23	309	332
fillor	"Jusuf Gërvalla"	Fsh.Biçec	28	331	359
fillor	"Idriz Seferi"	Fsh.Bob	36	507	543
fillor	Kadri Zeka	Fsh.Dubravë	32	425	457
fillor	"Avdylgafurr Luma"	Fsh. Glloboqicë	14	157	171
fillor	"Agim Bajrami"	Fsh. Stagovë	15	150	165
fillor	"Dituria"	Fsh. Ivajë	23	119	142
fillor	"N. Frashëri"	Fsh. Kotlinë	16	64	80
fillor	"Ali Asllan"	Fsh. Doganaj	25	354	379
Enti parashkollor	"Agimi"	Kaçanik	41 (0-5 vjet)	494 (parashkollor)	535
<b>G j I T H Ë S E J Ë:</b>			488	6235	6723

## IV.2. SHËNDETËSIA

### IV.2.1. Kapacitetet mjekësore (publike dhe private)

Shërbimi parësorë shëndetësorë publikë në territorin e komunës së Kaçanikut udhëhiqet nga komuna dhe kryhet në :

**Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare(QKMF) “Dëshmorët e Lirisë”- Kaçanik në koordinim me QMF-të dhe AF-të në zonat Rurale siç janë:**

- a. **QMF----- Bob**  
Ambulanca familjare Ivajë
- b. **QMF ---- Kaçanik i Vjetër**  
Ambulanca Familjare Begrac  
Ambulanca Familjare Stagov
- c. **QMF ---- Doganaj**  
Ambulanca familjare Dubrav  
Ambulanca Familjare Biqec  
Ambulanca Familjare Elezaj
- d. **QMF ----- Glloboçicë**  
Ambulanca Familjare Kotlin  
Ambulanca Familjare Strazh

Në QKMF-në e Kaçanikut puna është e organizuar në dy ndërrime, derisa emergjenca ofron shërbime 24 orësh. Gjatë vitit 2008 janë realizuar gjithsej 125460 shërbime shëndetësore, prej të cilave 52396 vizita dhe 73064 intervenime. Largësia më e madhe e vendbanimeve që gravitojnë në QKMF-në e Kaçanikut, nuk është më e madhe se 3.5km. shërbimet primare shëndetësor, shërbimet sociale dhe shërbimet të inspektimit sanitar.

Në këtë qendër e cila mbulon me shërbime territorin e Kaçanikut dhe fshatrat përreth kanë qasje 17314 banor ose 45.37% e popullatës së komunës.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) **“Dëshmorët e Lirisë” në Kaçanik**, si bartëse e kujdesit primarë , është e vendosur në qytetin e Kaçanikut dhe ofron shërbime ne një ndërtesë me hapësirë **2100.86 m<sup>2</sup>** . Ky objekt është ndërtuar në vitin e 2017 në participim, Komuna, Qeveria dhe Caritasi i Luxemburgut.

### *Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dëshmorët e Lirisë” - Kaçanik*

Në QKMF në Kaçanik ofrohen këto shërbime shëndetësore :

- Shërbime laboratorike
- Shërbime rëntgenologjike
- Shërbimet e vaksinimit – i rregullt
- Shërbimet stomatologjike
- Shërbimet e emergjencës
- Shërbimet gjinekologjike – ku rregullisht i jepen këshilla nënave shtatzëna

Mbrojtjen shëndetësore në komunën e Kaçanikut e ofrojnë **104** të punësuar prej të cilëve **12** specialistë, **12** me kualifikim superior, **4** me kualifikim të lartë **58** shërbyes me kualifikim të mesëm, **6** punëtorë administrate **7** shoferë dhe **5** pastruese.

*Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dëshmorët e Lirisë” - Kaçanik*

Tabela: IV.2.1.1. Struktura profesionale në QKMF, sipas profileve, është si në vijim

Nr.	Profesioni	
1.	Specialist të mjekësisë familjare	8 (tetë)
2.	Specialist i biokemisë	1 (një)
3.	Specialist i radiologjisë	1 (një)
4.	Specialist i oftomologjisë	1 (një)
5.	Specialist i stomatologjisë	1 (një)
6.	Doktor të medicinës të mjekësisë familjare	5 (pesë)
7.	Doktori i stomatologjisë të mjekësisë familjare	1 (një)
8.	<i>Mjek në specializim</i>	
9.	Mjek në specializim në Pediatri	2 (dy)
10.	Mjek në specializim në Kardiologji	2 (dy)
11.	Mjek në specializim në Reumatologji	1 (një)
12.	Mjek në specializim në Gjinekologji	1 (një)
13.		
14.	<i>Gjithësejt mjek</i>	<i>24 (njëzet e katër)</i>
15.	<i>Kuadri i lartë dhe i mesëm medicinal</i>	
16.	Infermier të diplomuar (Bachelor)	4 (katër)
17.	Infermiere	35 (tridhjet e pesë)
18.	Mami	18 (tetëmbëdhjetë)
19.	Laborant	4 (katër)
20.	Teknik rentgeni	1 (një)
21.		
22.	<i>Gjithësejt , kuadër i lartë dhe i mesëm</i>	<i>62 (gjashtëdhjet e dy)</i>
23.		
24.	Punëtor administrate	6 (gjashtë)
	Shofer	7 (shtatë)
	Pastruese	5 (pesë)
25.	<i>Gjithësejt</i>	104

#### IV.2.2. Mjetet dhe mundësia e informimit dhe e alarmimit

**Telefonia Fikse** – Rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Kaçanikut është i lidhur nëpërmjet fibrës optike, i cili i përket linjës së trasesë Ferizaj–Han i Elezit.

Ky rrjet menaxhohet nga njësi e PTK-së, në Kaçanik e cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibrë optik. Kapaciteti total i centralit të postës së Kaçanikut gjithsej 4500 qifte, prej të cilave 890 shfrytëzohen, ndërsa pjesa tjetër janë të pa shfrytëzuara.

Propozohet që të vazhdohet ndërtimi i rrjetës së telefonisë fikse në vendbanimet: Rekë, Stagovë, Begracë, Koxhaj, Bajnicë dhe Semajë

Me lidhje telefonike qoftë publike qoftë speciale(mobile) janë të mbuluara subjektet e më poshtme:

- stacioni policor ( **192** ) **0290-380-834** zyrtar, kujdestaria,
- Nj.P.Z.Sh Kaçanik **044/228-228** Qendra e Alarmimit -**112** Gjilan dhe - Radio Kaçaniku
- Shëndetësia (shërbimi urgjent dhe punktet aty ku ka mundësi me lidhje fikse **0290-380-222** kurse në vendet tjera me telefoni mobile) ( **194** )
- Organizmat tjerë shoqëror
- Qendra Operative Regjionale e Lajmërimit dhe Alarmimit në Gjilan (**112**)

Mjetet dhe mundësit e alarmimit (Sirenat, altoparlantët, radiot dhe TV -te):

Territori i komunës nuk është i mbuluar me sistemin e alarmimit.

Territori i komunës mbulohet me valët e TV stacioneve dhe atë të:

- RTK
- KTV
- TV21

### IV.3. FURNIZIMI ME UJË

#### IV.3.1. Sistemi dhe kapaciteti i furnizimit me ujë

Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit (të ujërave të zeza dhe ujërave të shiut ) në Kaçanik menaxhohet nga ndërmarrja publike rajonale “Bifur” e cila ka një marrëveshje të shërbimit me Komunën dhe është e licencuar për këtë qëllim. Ujësjellësi në Kaçanik e merr ujin nga pesë burime me kapacitet total  $Q=40-44$  litra/sec, varësisht në sezon. Këto resurse ujore për furnizim me ujë të pijshëm janë kryesisht burime natyrore në rrëzë të malit Lypeten

Resurset ujore janë kryesisht burime natyrore dhe ndodhen në pjesën e identifikuar si zona e vlerave natyrore perëndimore. Një pjesë e konsiderueshme e popullatës të komunës rreth 23%, kanë sisteme lokale, të cilat nuk menaxhohen nga NPK “Lybeteni. Këto sisteme e marrin ujin nga burime natyrore dhe shpimet nëntokësore. Nga këto sisteme, në bazë të sasive të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditor për banor, vlerësohet të jetë përafërsisht 200-250 litra në ditë.

- Burimi më i madh i quajtur “**Uji i Bardhë**”, ndodhet në lartësi mbidetare 1475 m në territorin kadastral të Dubravës dhe ka kapacitet  $Q=18-24$  litra/sec.
- Burimi i dytë natyror “**Rreka e kafexhisë**” ndodhet në territorin e Glloboshicës dhe është në largësi 700m nga burim i parë, me kapacitet  $Q=16$  litra/sec. Uji nga burimet me gypa PE (polietileni) me diametër  $\varnothing$  110mm në gjatësi rreth 700m, grumbullohet në pushimoren e përbashkët me dimensione 3.2mx3.4m. Prej kësaj pushimoreje me gyp  $\varnothing$  225mm dhe gjatësi 800m uji përcjellët në odën e parë ndërprerëse.
- Burimi i tretë me kapacitet  $Q=5$  litra/sec ndodhet në lartësi mbidetare rreth 1600m (ana perëndimore e territorit të **Glloboçicës**). Në nivelin e odës së parë ndërprerëse, uji nga ky burim i shtohet rezervuarit-pushimorës.

Në territorin e Ivajës ndodhen edhe dy burime natyrore me kapacitet  $Q=2 \times 2.5$  l/sec të cilat me gypa AC- asbest cimet  $\varnothing$  150mm të vendosura në vitin 1968, derdhën në rezervuarin e përbashkët. Rrjeti kryesor i sistemit të ujësjellësit nga burimi deri te rezervuari kryesor shtrihet në terren me konfiguracion mjaftë të pjerrët në të cilin janë të shpërndara 14 odat ndërprerëse të cilat kanë funksion të rregullimit të presionit të rrjedhjes së ujit. Këto oda ndërprerës, të gjitha me dimensione 3.20x3.40m, janë të vendosura në vazhdim në tubacionin kryesor  $\varnothing$  225mm. Në territor të Ivajës ndodhet rezervuari-pushimore me kapacitet  $V=120\text{m}^3$ , ku bëhet dezinfektimi i ujit dhe degëzimi i parë i rrjetit shpërndarës për lagjen e Dushkajës, dhe me gypa polietilen  $\varnothing$  125mm deri  $\varnothing$  150mm, varësisht nga terreni, vazhdon deri te rezervuari qendror me kapacitet  $V=440\text{m}^3$  ( dy basene  $2 \times 220\text{m}^3$  ) i cili ndodhet në vendin e quajtur Livadhet e Bobit në 555m lartësi mbidetare. Prej këtu vazhdon rrjeti shpërndarës kryesor  $\varnothing$  220mm në gjatësi 1600m dhe rrjeti degëzues për qytet  $\varnothing$  63 mm me gjatësi 21 km. Sistemi i ujësjellësit të Kaçanikut furnizon me ujë qytetin e Kaçanikut dhe dy vendbanimet Bob dhe Runjevë. Në këtë sistem kanë qasje 15958 banorë, ose 41.80% të popullatës të përgjithshme në komunë.

**Shfrytëzuesit e ujësjellësit janë:**

1. Amvisnit,
2. Zejtarët,
3. Institucione publike,
4. Xhamitë

#### **IV.4.Rrjeti energjetik**

Pozita gjeografike e komunës i mundëson edhe një rrjet të rëndësishëm, të furnizimit me energji elektrike. Përveç linjave të furnizimit me energji elektrike me kapacitet 35kv, të cilat vijnë nga drejtimi i Ferizajt, në territorin e komunës kalon edhe linja transite e tensionit të lartë Internacional (Prishtine – Ferizaj – Shkup) dhe Shtetëror (110KV) Bibaj, Kaçanik – Han i Elezit).

**IV.5. Shërbimet e Internetit** – Ekzistojnë disa operator të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në zonën urbane të Kaçanikut, të cilët e mbulojnë shumë mirë tërë territorin e zonës urbane. Kryesisht interneti në zonën urbane është i shpërndarë në nivel të internet kafe-ve, lidhje individuale dhe lidhjeve të institucioneve të caktuara. Operatorët me ndikim më të madh, që ofrojnë shërbime të internetit janë:

- **PTK** - Darda NET, nëpërmjet të telefonisë fikse
- **IPKO** – ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale) dhe
- **KUJTESA** - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale)

#### **IV.6.Shërbimet Postare**

**Posta** në zonën urbane të Kaçanikut shpërndahet e klasifikuar sipas rrugëve dhe adresave të cilat janë të evidentuara në bazën e të dhënave të PTK-së, njësia në Kaçanik.

#### IV.7. Llojet e strehimoreve, kapacitetet e tyre dhe objektet tjera për strehim .

Në bazë të gjendjes faktike, në qytetin e Kaçanikut ekzistojnë dy strehimore publike (me kapacitet prej 130vetash) që i kanë plotësuar kushtet për atë kohë

që janë ndërtuar, dhe ato gjenden në Gjimnazin „Skënderbeu“ dhe te banesa e madhe (11 katëshja) në qendër të Kaçanikut, strehimoret për momentin nuk janë të mirëmbajtura, dhe nuk i plotësojnë kushtet për strehim.

Qytetarët e Kaçanikut në raste emergjente, do të mund të strehoheshin në objekte afariste dhe publike, në të cilat ekzistojnë kushte minimale për strehim (fjala është për objektet me podrum), sikur që është ish shtëpia e mallrave “Sharri“, Objekti i ”BK”-së” Objekti i Policisë, Shkollat, Komuna, shtëpia e kulturës si dhe banesat që podrumet i kanë të ndërtuar me material të fortë.

Këto podrume (strehimore ),tash për tash janë jashtë përdorimit, sepse nuk janë bërë investime për aftësimin- (restaurimin) e tyre.

Nr	Lloji i strehimores	Lokacioni	Agjensioni menaxhues	Kapaciteti në individ	Koha e qëndrimit në orë		
					Afatshk urtë (48)	Afatmes em (15ditë)	Afatshgj atë (60 dt)
1	Nëntokësore	Agim Bajrami	Shtëpia e mallrave “Sharri”	70	X		
2	Nëntokësore	Banesa e madhe	Kuvendi Komunal	75	X		
3	Nëntokësore	Gjimnazi “Skënderbeu”	Kuvendi Komunal	80	X		
4	Restoran	Bul.”Ismal Raka”	“Arti”	80	X		
5	Nëntokësore	UÇk	Policia e Kosovës	20	X		
6	Shtëpia e Kulturës	Bul.”Ismal Raka”	Kuvendi Komunal	60	X	X	
7	Objekt banimi	Ish Saniteksi	Kuvendi Komunal	50		X	X
8	Objekt banimi	Shkolla e mesme Profesionale	Kuvendi Komunal	80			
9	HotelRestoran	Magjistrale	Fontana	150	X		X
10	Hotel Restoran	Magjistrale	Mani	150			X
11	Hotel Restoran	Magjistrale	Evropa 92	150			X
12	Hotel Restoran	Magjistrale	Parku	150			X
13	Hotel Restoran	Magjistrale	Beni	100			X
14	Hotel Restoran	Magjistrale	Liburna	150			X
15	Nëntokësore	Bul.”Ismal Raka”	“B&K”	100		X	

## V. GJENDJA AKTUALE E SHËRBIMEVE EMERGJENTE

### V.1. Njësia Profesioniste e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit

Komuna e Kaçanikut ka Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit e cila posedon këto mjete teknike:

- 1.Gjip komandues - Toyota (intervenojnë 2 ose më shumë persona) me sasi uji deri 500l.
- 1.Automjet Sulmues 1 copë me sasi uji prej 2.400 l. posedojnë pompat e ujit për fikjen e zjarreve, ka aparate për fikjen e zjarrit:2 aparate CO2 dhe 2 aparate P-9 nga 9 kg pluhur.
- 1.Automjet përcjellës me sasi uji prej 5.000 l. intervenimi bëhet me 2 deri 3 persona.
- 1.Automjeti sulmues-teknik për aksidente rrugore dhe avari tjera është i kompletuar me të gjitha pajisjet për aksidentet rrugore.
- 1.Automjeti për shuarjen e zjarreve malore tip IVEKO me sasi uji deri 1000l me të gjitha pajisjet e nevojshme për shuarjen e zjarreve malore dhe fushore.
- Orari i një ndërrimi është **12 orë dhe atë, prej 08.00-20.00**, në ndërrim angazhohen 2 zjarrfikës dhe 2 vozitës - zjarrfikës
- Gjatë orarit të punës **08.00-20.00** mund të angazhohen edhe Komandanti dhe oficeri për preventivë.
- Njësia është e plotësuar me 16 zjarrfikës, komandanti i Njesisë, dhe Oficeri i preventivës. Ky numër i zjarrfikësve nuk është i mjaftueshëm për komunën e Kaçanikut.

## V.2. Lista e personelit sipas ndërrimeve dhe detyrave

Kjo renditje është e përkohshme dhe ka mundësi ndryshimi në rast nevoje

1. Ylber Shehu	- (Komandant i Njësisë).....	044/224-812
2. Naser Kuka	- (Inspektorë i parandalimit dhe preventivës).....	045/300-469
<b>Ndërrimi i parë :</b>		
1. Xhelal Hasani	- udhëheqës ndërrimi-.....	044/224-849
2. Shahin Loku	- zjarrfikës.....	044/224-632
3. Zija Hoxha	- vozitës zjarrfikës.....	044/279-795
4. Ali Palloshi	- vozitës zjarrfikës .....	044/281-036
<b>Ndërrimi i dytë :</b>		
1. Fadil Mulaku	- udhëheqës ndërrimi.....	044/930-499
2. Nazim Demnika	- zjarrfikës.....	049/473-098
3. Arlind Bela	- vozitës, zjarrfikës.....	045/663-359.
4. Agron Trena	- zjarrfikës.....	044/735-765
<b>Ndërrimi i tretë :</b>		
1. Lulzim Gashi	- udhëheqës ndërrimi .....	044/280-995
2. Bekim Dema	- vozitës, zjarrfikës .....	044/197-217
3. Agim Krivenjeva	- vozitës zjarrfikës .....	044/142-085.
4. Bajram Shehu,	- zjarrfikës.....	044/224-813
<b>Ndërrimi i katërt :</b>		
1. Abaz Burrniku	- udhëheqës ndërrimi .....	044/711-572
2. Idriz Loku	- vozitës, zjarrfikës.....	044/406-201
3. Valon Kuka	- zjarrfikës .....	045/586-645
4. Vahid Mulaku	- zjarrfikës.....	044/721-632

**Çdo ndërrim i ardhshëm eventual është ndërrim rezervë-“Në Gatishmëri”**

## V.3. Aktivizimi i planit të reagimit emergjent


Fillimi i fatkeqësisë (emergjencës) krijon nevojën për veprime të ndryshme dhe të ndjeshme për nga koha që të shpëtohen jetët dhe pasuria, e gjithashtu edhe për veprime për ta filluar stabilizimin e situatës, në mënyrë që juridiksioni të mund të rigrupohet.

Reagimi i tillë përfshin lajmërimin e personelit për menaxhimin emergjent të krizave, paralajmërimin dhe evakuimin ose strehimin e popullatës, informimin e opinionit publik, shpëtimin e individëve dhe sigurimin e trajtimit mjekësor, mbajtjen e rendit dhe të ligjit, vlerësimin e dëmeve, adresimin e çështjeve të lehtësimit që dalin nga aktivitetet e reagimit, madje kërkimin e ndihmës nga jashtë - juridiksioni.

### V.3.1. Aktivizimi i alarmit përgjegjësia për alarm dhe pasqyra e përfshirjes fillestare të incidentit

- Policia do të filloj paralajmërimin e sistemit të Alarmimit dhe koordinimit emergjent.
- Zyra e alarmimit dhe koordinimit emergjent komunal do të kontaktoj tërë personelin në listë.
- Nëse një person përgjegjës s'mund të kontaktohet përmes telefonit ose radios, atëherë do të dërgohet vozitësi.

Fig: pasqyra e përfshirjes fillestare të incidentit



Meqë ngjarjet emergjente fillojnë në nivel komune, do të thotë se përgjegjësia bie mbi komunën, e nëse eskalon situata, atëherë kompetencat tejkalohe në qendra rajonale. Nëse situata tejkalon edhe nivelin e përgjegjësise dhe mundësisë për veprim të rajonit të caktuar, atëherë kërkesa shkon në nivel të Agjencisë për Menaxhim të Emergjencave. Nëse përmbushen elementet e parapara me ligj, Ministria për Punë të Brendshme i jep propozim Kryetarit të shtetit, e ky i fundit vlerëson nëse duhet shpallur gjendjen e jashtëzakonshme ose në të kundërtën e kthen kërkesën për menaxhim nga MPB.

#### **V.4. Faza e Përgjigjes kalon në këto etapa:**

##### **Etapa 1: "Alarm për rritjen e gatishmërisë"**

Drejtori i DSHPE-së ose shefi i sektorit të emergjencave vendos fillimin e etapës 1, "alarm për rritjen e gatishmërisë", në çastin e marrjes së informacionit për mundësinë e ndodhjes së një zjarri i cili mund të shoqërohet me dëmtime në njerëz dhe dëme materiale.

##### **Etapa 2: Vendosja e Gjendjes së Gatishmërisë**

Drejtori i DESHP-së vlerëson nevojën e fillimit të etapës 2, "vendosjes së gjendjes së gatishmërisë". Kjo bëhet kur një ngjarje e afërt zjarri konsiderohet e pashmangshme dhe që mund të shoqërohet me dëme në njerëz dhe të mira materiale.

##### **Etapa 3: Aktivizimi**

Fillon në rastet kur një ngjarje e papritur zjarri ka shkaktuar dëmtime materiale ose edhe në njerëz.

##### **Etapa 4: Dalja nga Situata**

Njoftimi për etapën 4, "daljen nga situata", bëhet nga i njëjti autoritet që e ka urdhëruar fillimin e etapës 1, 2 ose 3.

**Etapa 4: "dalja nga situata"**, paraqet situatën normale në vend, kur nuk ekziston kërcënim i drejtpërdrejtë.

##### **Në çdo rast dalja nga situata bëhet kur:**

- Është bërë vlerësimi i plotë i situatës.
- Kërcënimi i fatkeqësisë është zvogëluar.
- Operacionet e ndihmës kanë dhënë rezultatet e duhura.
- Nevojat më të nevojshme janë plotësuar

#### **V.5. Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Parandalimit dhe Lehtësimit**

- Faktorët e parandalimit, si fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe institucional, mund të kenë ndikim të rëndësishëm në uljen e rrezikut. Këto fushata mund të ndërmerren në nivel qendror, nivel rajonal dhe lokal, sipas nevojave specifike të rreziqeve në zonën përkatëse.
  - Publiku dhe institucionet duhet të jenë të ndërgjegjshëm për legjislacionin ekzistues, që ndalon ndezjen e zjarreve në zonat me rrezik të lartë dhe rregullat duhet të jepen si mesazhe të thjeshta.
  - Një sistem serioz vëzhgimi dhe patrullimi ndihmon në ndërgjegjësimin, informimin dhe zbatimin e legjislacionit.
  - Mund të nevojiten ndryshime në praktikat bujqësore për sa u përket rreziqeve në rritje.
- Alternativa, opsione dhe udhëzime mund të jenë të nevojshme për të rritur ndërgjegjësimin për mos djegien e kullotave në periudhat kur rrezikshmëria e përhapjes dhe e daljes jashtë kontrollit është e lartë.

#### **V.6. Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Parapërgatitjes dhe Mbrojtjes**

- Inkurajimi dhe zbatimi i masave ekzistuese të mbrojtjes, si për shembull, barrierat për parandalimin e zjarrit, kullat për monitorimin e pyjeve dhe një situatë patrullimi i përforcuar për pyjet, është çelësi për mbrojtjen e zonave të mëdha nga zjarret.
- Mbështetja dhe përforsimi i një rrjeti të përhershëm ekzistues të mbikëqyrje-sinjalizimit (me disa kulla vrojtimi) jep këtë përgjigje thelbësore të hershme.
- Investimet, fuqizimi dhe përdorimi racional i teknikës mund të çojnë në përbalim të situatës përpara se kjo e fundit të mos mund të kontrollohet nga njeriu.

#### **V.7. Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë fazës së Përgjigjes**

- Shpejtësia e përgjigjes është faktori kryesor në parandalimin e përhapjes së zjarrit në një pyll të vogël ose të zjarrit në shkurre, për të mos marrë përmasat e një emergjence civile.
- Drejtimi i zjarrit është shumë i paparashikuar dhe e gjithë popullsia vendëse ose e përkohshme në çdo rast duhet të përgatitet për t'u evakuuar. Evakuimi duhet të bëhet mundësisht sipas planeve të gatishmërisë ekzistuese dhe të testuar.
- Duhet të identifikohen dhe të paracaktohen zonat e sigurta për evakuimin së bashku me rrugët e sigurta për të shkuar në ato zona që ekzistojnë ose që janë dhënë si mundësi.
- Publiku dhe institucionet duhet të mbahen të mirinformuara nëpërmjet mjeteve të nevojshme (si për shembull, stacioneve lokale të radiove) dhe duhet të lejohen ose të inkurajohen të kthehen në shtëpitë e tyre kur situata të jetë përsëri absolutisht e sigurt.
- Në emergjencat e zjarreve të një madhësie të konsiderueshme mund të kërkohet ndihmë ndërkombëtare për shuarjen e zjarrit, si për shembull zjarrfikës të fuqishëm, helikopterë dhe avionë të prodhuar posaçërisht për këtë qëllim, veçanërisht nga vendet fqinje

#### **V.8. Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Rikthimit në Gjendjen Normale**


- Dëmtimet në lidhjet e transportit, të energjisë elektrike dhe të telekomunikacioneve duhet të jenë me përparësi për t'u rregulluar, sapo situata të jetë e sigurt për të bërë një gjë të tillë.
- Situata duhet të monitorohet nga afër për shpërthime të papritura të vatrave të zjarrit fillestar ose të zjarreve dytësore, që ndodhin nga i njëjti shkak fillestar ose nga materialet djegëse që zhvendosen nga era.
- Kthimi i situatës në normalitet sjell mundësi për të mësuar nga një rishikim i plotë i shkaqeve dhe ndikimit të asaj çfarë ndodhi, duke analizuar rëndësinë e paralajmërimit në kohën e duhur dhe në mënyrën e përshtatshme si dhe përgjigjen e duhur.
- Një rishikim i plotë siguron përmirësime të mundshme gjatë operacioneve të përballimit, të parandalimit dhe të lehtësimit të situatës së krijuar.
- Humbja ekonomike që vjen si rezultat i zjarrit, duhet të paraqitet me koston e mundshme të lehtësimit kundrejt një situatë të përsëritur, si mjet për të kërkuar investime për parandalimin.
- Etapa e menjëhershme e pas ngjarjes, mund të paraqesë një mundësi për të aplikuar për burime shtesë për parandalimin, lehtësimin dhe mbrojtjen.

## VI. STRUKTURA E ORGANIZIMIT TË ZYRËS PËR ALARMIM

### VI.1. Zyra për alarmim dhe koordinim emergjent (ZAKE).

Ekipi i menaxhimit të Emergjencës (EME), në raste të aksidenteve (katastrofave ) të mëdha do të aktivizohet sipas skemës të paraqitur.

### STRUKTURA E ORGANIZIMIT TË ZYRËS PËR ALARMIM



Zyra për alarmim dhe koordinim emergjent (ZAKE)- aktivizohet me urdhër të Kryetarit të Komunës

## **VI.2. Detyrat E e zyrës për alarmim dhe koordinim emergjent**

- Kontrolli dhe komunikimet e Operacioneve të Emergjencës
- Koordinimi i pajisjeve Emergjente dhe personeli
- Lidhjet direkt me subjektet relevante të komunës dhe me (QKER) Qendra e Koordinimit Emergjent Regjional Gjilan
- Përhapjen e informatave në media, zëdhënës zyrtar, etj.
- Kërkime për burime të mëtejme të nevojshme.

### **VI.2.1. Personeli:**

- Zyrtari i ZAKE-s
- Zyrtari i sigurimit lokal
- Zyrtari i Shëndetësisë
- Zyrtari për Zjarrëfikje dhe Shpëtim
- Zyrtari i Policisë oficeri lokal
- Zyrtari i Forcave të Sigurisë së Kosovës (sipas kërkesës)

## **VI.3. Komandanti i incidentit (KI)**

### **VI.3.1. Detyrat:**

#### **Komandanti i Incidentit do të:**

- Verifikon gatishmërinë për intervenim të njëjësive emergjente dhe resurseve tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
  - udhëheq mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të fatkeqësive;
  - siguroj ndërlidhje dhe veprim të koordinuar për të gjitha SMSHN;
  - bëj propozime lidhur me përgatitjen e SMSHN si dhe për rimëkëmbje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
  - Kërkoj aktivizimin e Qendrave Operative Emergjente.
- Komandanti i Incidentit mund të caktoj përgjegjës për të menaxhuar intervenimet individuale të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.<sup>9</sup>

## **VI.4. Kompetencat e veçanta të KI**

**VI.4.1.** Në drejtimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, Komandanti i Incidentit ka të drejtë dhe detyrë të ndaloj qasjen e personave të paautorizuar në zonat e goditura dhe të urdhëroj që:

- njerëzit, kafshët dhe të mirat materiale të zhvendosen nga ndërtesat dhe zonat e goditura;
- të lejohet qasja në strehimore;
- të mundësohet përdorimi apo vendosja e mjeteve të veçanta të komunikimit;
- të bëhet largimi i pengesave që pengojnë intervenimin e suksesshëm;
- të vihen në dispozicion për përdorim mjeteve private të transportit për bartjen e të lënduarve apo mjeteve të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- qytetarët e përgatitur të marrin pjesë në aktivitetet e shpëtimit në përputhje me
- aftësitë dhe resurset e tyre të përshtatshme për shpëtim;
- pronat private të përdoren për qëllime të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
- pronat të përdoren si depo të përkohshme për rrënoja, pjesë dhe materiale tjera të dala gjatë kryerjes së detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës të destinuara për sigurimin e kushteve elementare për jetë;

<sup>9</sup> Ligji Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera neni 81

- Masat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, mund të urdhërohen vetëm atëherë kur asnjë masë tjetër nuk mund të siguroj mbrojtje të njerëzve dhe pronave si dhe zbatim të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe duhet të aplikohen jo më shumë se sa është plotësisht e domosdoshme.
- Zhvendosja e njerëzve nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të urdhërohet nëse jeta e tyre gjendet para rrezikut të pashmangshëm për shkak të zjarrit, eksplozimit apo rrezikut tjetër për kohëzgjatjen e rrezikut të tillë. Policia e Kosovës duhet të ndihmoj zhvendosjen.
- Gjatë mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës Komandanti i Incidentit ka të drejtë t'i urdhëroj institucionet dhe organizatat tjera nënshkruese të kontratave, organet kompetente qendrore apo lokale, për zbatimin e detyrave të veçanta sipas këtij ligji, punë urgjente ndërtime, teknike dhe të tjera.
- Nëse detyrat duhet të kryhen me qëllim të shpëtimit dhe mbrojtjes së njerëzve, pronave, kafshëve apo mjedisit apo për mbrapsjen e rrezikut të pashmangshëm, komandanti i incidentit ka të drejtë që të urdhëroj që këto detyra të kryhen nga personat fizik dhe juridik të cilët kanë kapacitet apo pajisje adekuate.
- Urdhri duhet të jetë me shkrim apo në situatat e papritura edhe me gojë dhe duhet të precizoj llojin dhe shtrirjen e punës që duhet kryer.
- Për urdhëratë e dhëna nga Komandanti i Incidentit duhet të mbahen shënime. Për vendimet me implikime të mëdha financiare duhet të lëshohen urdhra me shkrim. Kur e lejojnë rrethanat duhet të lëshohen urdhra me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur. Në rastet urgjente Komandanti i Incidentit duhet të ketë të drejtë që të urdhëroj pronarët privat të objekteve të banimit apo objekteve tjera, të ofrojnë strehim dhe kujdes të përkohshëm për personat e kërcënuar derisa të merret vendimi nga Kryetari i Komunës apo Qeveria.
- Nëse operacionet e mbrojtjes dhe shpëtimit drejtohen nga autoritetet përgjegjëse regjionale apo qendrore, vendimi për mbulimin e shpenzimeve të punëve urgjente të menaxhuara nga autoritetet e komunitetit lokal duhet të bëhet nga Kryetari i Komunës.<sup>10</sup>

#### **VI.4.2. Posti i komandës**

- Komanda e Operimeve në vendin e ngjarjes.
- Koordinimi i ekipeve të ndryshme
- Kërkimin e burimeve të mëtejshme të nevojshme (Njerëzore dhe materiale -teknike) nga ZAKE-të.

#### **VI.4.3. Personeli:**

- Zyrtari i zjarrëfikësve
- Oficeri i Postit komandues (PK)
- Zyrtari nga Shërbimi i Emergjencës Mjekësore,
- Zyrtari i FSK-s (sipas kërkesës)

<sup>10</sup> Ligji Nr. 04/L-027 Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera neni 82

## VI.5. Pasqyra e subjekteve përgjegjëse për Reagim në raste Emergjente për Komunën e Kaçanikut

Nr.	Njësia	Telefoni
1.	Policia e Kosovës	0290/380-834
2.	Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit	112- Qendra e Alarmimit - Gjilan 044/228-228 NjPZSh- Kaçanik
3.	Shërbimi emergjent mjekësor	0290/380-222
4.	KEDS - Kaçanik	0290/380-435
5.	Ujësjiellësi	0290/380-113
6.	Kryqi i Kuq Komunal	044/224 -779
7.	OJQ-të e ndryshme	

## VII DETYRAT E EKIPEVE TË REAGIMIT EMERGJENTË (ERE)

### VII.1. Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (NJPZSh)

- Në raste të aksidenteve të mëdha (katastrofave), Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit do të kryejë këto veprime:
- Zjarrfikje dhe kërkim shpëtim si dhe detyrat tjera në rast zjarri
- Do të pozicionojnë dhe të ndalin zjarret përgjatë rrugëve të trupave(njisive) dhe përgjatë rrugëve ku zhvillohen operacionet e shpëtimit.
- Do të sigurojnë hyrje për shpëtimtarët për në lokacionet me tym. Misione shpëtuese lidhur me aksidente dhe katastrofat natyrore,( eksplozim, rrjedhat e vajrave, rrjedhjet e gazit apo lëngjeve, incidentet me ujë, vërshimet dhe shirat e mëdha, shembje dheu, aksidentet në komunikacion,etj.).
- Do të sigurojnë operacione të shpëtimit në pyje.
- Ekzekutimin e evakuimit në rast zjarri.

### VII.2. Policia e Kosovës

Policia e Kosovës në raste të aksidenteve të mëdha (katastrofave) do të kryejnë:

- Hetimet .
- Sigurimi i kontrollit në vend të ngjarjes.
- Sigurimin e lëvizjes së trafikut në vendin e ngjarjes dhe përreth.
- Mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave.
- Ekzekutimin e evakuimit në rast eksplozimi

### **VII.3. Shërbimi Mjekësor i Emergjent**

Njësitë profesionale të Shërbimeve Emergjente Mjekësore ( ekipet mobile ) në raste të aksidenteve të mëdha duhet të kryejnë shërbime mjekësore emergjente dhe të ndihmojnë në zhvendosjen e popullatës nga zonat e goditura dhe të koordinojnë aktivitetet me institucionet relevante. Ekipet e ndihmës së parë i bashkëngjiten shërbimit mjekësorë emergjent dhe i nënshtrohen urdhrave të zyrtarit të këtij shërbimi

### **VII.4. Forcat e Kosovës (KFOR-i)**

KFOR-i do të ndaj mjete për reagimin ndaj emergjencës për ndonjë rast varësisht nëse ka mjete ose ka kufizime kombëtare. KFOR-i gjithmonë do të përpiqet të sigurojë ndihmë emergjente në rast se ka gjasa të humbet jeta ose të shkaktohen rreziqe serioze të ambientit.

Sidoqoftë, kjo mundësi nuk duhet të konsiderohet si prioritet i parë i shërbimeve të emergjencës lokale.

#### **VII.4.1.Detyrat.**

- Sigurimi i forcave civile (përcjellja dhe mbrojtja)
- Misione shpëtuese lidhur me aksidentet ose katastrofat natyrore ( eksplozimi, derdhja e naftës, rrjedhje e gazit ose e gjërave të lëngëta, incidente të ujit, vërshime dhe shira të mëdha, rrëshqitje e tokës, aksidente rrugore, etj.)
- Fikje zjarri dhe detyra tjera në rast zjarri
- Shërbime emergjente mjekësore
- Mbështetja e sistemit të komunikimit
- Ndihma për zbatimin e evakuimeve

### **VII.5. Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK)**

Forcat e Sigurisë së Kosovës në raste të nevojave emergjente do t'i kryej këto detyra:

- Të sigurojnë shërbime në raste të fatkeqësive,
- Të kryejnë kërkim dhe shpëtim,
- Të siguroi asistencën humanitare në regjionet e izoluara,
- Të kryejnë shërbime emergjente mjekësore,
- Zbatimin e detyrave të transportit sipas kërkesës,
- Ndihmë për zbatimin e evakuimit.

### **VII.6. Shërbimet tjera**

Komiteti Emergjent në raste të katastrofave do të angazhoj edhe ekipe tjera të përbëra nga organizatat qeveritare dhe private për sanimin e gjendjes të krijuar nga fatkeqësitë natyrore.

DESHP, ka bërë evidentimin e organizatave dhe pronarëve të tyre si dhe pajisjet më qëllim të angazhimit në raste konkrete, shënimet janë tubuar nga firmat përkatëse-ani pse janë prezentë ndryshimet e mëdha të gjendjes në funksionimin e disa firmave.



## **VII.7. Zingjiri komandues**

Në raste të aksidenteve të mëdha, mbliidhet Komiteti i Reagimit Emergjent, Kryetari i komunës (ose nënkryetari) është Kryetar i Komitetit dhe njëkohësisht Komandant i përgjithshëm i situatës emergjente. Ekipi i udhëheqjes së emergjencës do të sigurojë gjithë ndihmën dhe përkrahjen e nevojshme. Komandant i incidentit (KI) në vendin e ngjarjes do të jetë një zyrtar i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, KI (Komandanti i Incidentit ) është i ndërlidhur me Komitetin e Reagimit Emergjent përmes ZAKE-s ( zyra për alarmim dhe koordinim emergjent)

### **VII.7.1. Komunikimi me publikun**

Në raste të krizës themelohet qendra informative e mediave pranë vendit të aksidentit, por larg nga qendra kryesore. Të punësuarit në zyrën për alarmim dhe informim zakonisht, drejtohen te kjo qendër dhe kanë për detyrë t'i shoqërojnë përfaqësuesit e mediave.

Reporterëve nuk duhet tu lejohet hyrja në zonën e rrezikshme, edhe pse do të dëshironin të shkonin atje, për kryerjen e kësaj detyre ndihmohen nga PK-ja. Me këtë rast zëdhënësi i Kuvendit Komunal ka për obligim grumbullimin dhe leximin e materialeve informative të përgatitura nga ekspertet. Materialet e grumbulluara paraprakisht i dorëzohen Kryetarit të komitetit nga ku duhet të marrim vizën për komunikatë në opinion. Qendra informative duhet të vendoset në një dhomë të përshtatshme, prej nga raportohet lehtë dhe mund të japin informata për gjendjen.

### **VII.7.2. Komunikimi dhe ndërlidhjet**

Komunikimi përreth vendit të ngjarjes:

- Vendi i komandës do të monitoroj të gjitha radiatorjetet dhe do të jetë qendër e të gjitha komunikimeve.
- Çdo ekip për reagim ndaj emergjencës do të ketë radiolidhjen e vetë të brendshme për komunikim brenda ekipit.
- Çdo ekip do të siguroj mundësin e ndërlidhjes me vendin e komandës (VK).
- Komunikimi nga vendi i komandës (VK) me Zyrën e Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent (ZAKE):
- Radiot e dorës, dhe telefonat celularë do të jenë mjetet primare për komunikim.
- Komandanti i incidentit (KI) do të komunikoj drejtpërdrejt me ZAKE.
- Do të caktohen edhe dy telefona celular për të ndihmuar komunikimin me ZAKE.
- Çdo e organizatë do të dërgojë një person për ndërlidhje me ZAKE.

### **VII.7.3. Njësit për Reagim Emergjent**

ZAKE do të aktivizohet në raste të emergjencave

Në postin e Komandës do të ketë një përfaqësues i çdo pjesëmarrësi në reagimin emergjent

## VII.8. PASQYRA E EKIPEVE DHE PERSONELIT PËR REAGIM EMERGJENT



### VII.8.1 Njësitë profesionale të zjarrfikësve dhe shpëtimit

- **Struktura:**

Shërbimi funksionon 24 orë pa ndërpre. Njësia përbëhet prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) Zjarrfikës, komandanti dhe oficeri i preventives .  
Posedojnë 3 kamion(autocisterna), një automjet teknik dhe një gjip komandues.

- **Pajisjet:**

Pompa e ujit,(nëse ka lum apo basen në afërsi shfrytëzohet për shuarjen e zjarrit)  
1 një pompë për mbushjen e cisternave me ujë  
pajisje teknike për aksidente në trafik dhe ndihmën e parë  
Gërshërët për prerjen e metalit në rast aksidenti 4 ( katër ) boca me oksigjen për intervenim litarët e alpinizmit, pajisjet për dhënien e ndihmës së par me imobilizim të thyerjeve

- **Organizimi:**

Ndërrimi është 24orë dhe atë prej 07:00 – 07:00 të ditës së nesërme. Në ndërrim janë 4 zjarrfikës.  
Vlen të ceket se punëtorët kur kanë nevojë për pushime vjetore, ose trajnime profesionale në Qendrën e Zjarrfikësve në Vushtrri, ose pushime mjekësore në raste të këtilla janë në ndërrim nga 2 zjarrfikës.

Në shumë raste ndërrimi në vijim ka nevojë për ndihmën e ndërrimit ekzistues.

Komandanti i njësisë është çdo ditë pune prej orës 08:00-16:00, si dhe oficeri i preventives po ashtu për çdo ditë pune prej 08:00 – 16:00

Mobilizimi i personelit të NjPZSh.në Kaçanik bëhet për 30-50'.



### VII.8.2. Njësitë e policisë

- Struktura, pajisjet dhe organizimi i ekipeve varen nga gjendja e krijuar pas fatkeqësisë Emërtimin e tyre e bën Komandanti i stacionit të policisë.



### VII.8.3. Shërbimet mjekësore emergjente

- **Struktura:**

- Shërbimi funksionon 24 orë plus 7 pa ndërpre. Në ndërrim është 1 (një) mjek, 2 (dy) teknik medicinal dhe 1 (një) vozitës,1 mami.
- QKMF. gjithsejtë ka 21 mjek dhe 67 teknik medicinal./motra medicinale
- QKMF.do të hartoj planin e reagimit emergjent në të cilin do të parashihen formimet e ekipeve për reagime në situata të ndryshme.
- -QKMF. posedon 2 autoambulanca në gjendje të rregullt me pajisje të duhura që mundëson funksionimin dhe angazhimet e përditshme, ndërsa në situata emergjente e bën intervenimin më të lehtë.
- Mobilizimi i personelit (motra, teknik medicinal) të QKMF. në Kaçanik bëhet për 60 min.

- **Pajisjet:**

- I Vetur e ndihmës së shpejt-24 orësh, më pajisje për ti kryer këto shërbime.
- Shikimi mjekësor
- Dhënia e terapisë komplet
- -//- -//- oksigjenit
- -//- -//- inhalacionit
- EKG – shërbimet
- Pastrim plagësh etj.

- **Organizimi:**

Prej orës 08:00-20:00 punon ndërrimi i parë

Prej orës 20:00-08:00 punon ndërrimi i dytë (çdo të tretën natë është në ndrim)

#### **VII.8.4. Trupat e FSK-së**

Angazhimi i ekipeve të FSK-së bëhet sipas urdhrit nga Komanda adekuate pasi të parashtrohet kërkesa në sektorin për marrëdhënie civilo ushtarake. Koordinimi i veprimeve të ekipeve në teren bëhet për mesë oficerit të cilin e emërton komanda.

#### **VII.8.5. KFOR-i**

Sipas kërkesës

### **VIII. PËRGJEGJËSIA KRYESORE DHE SUAZAT E PËRGJEGJËSISË PËR T'IU PËRGJIGJUR VEPRIMEVE**

**VIII.1.** Përgjegjësia e dorës së parë për Komandën e Reagimit për Emergjencë shpërndahet sipas tipit dhe shkallës së emergjencës.

- Komiteti për Reagim Emergjent, i kryesuar nga Kryetari i Komunës do të aktivizohet me komandën e gjithmbarshme për reagim.
- Komandant i incidentit (KI) në vend të ngjarjes do të jetë: një përfaqësues i emergjencave, një zyrtar politik ose zyrtar mjekësor, varësisht nga lloji i aksidentit.
- Në rast rrëzimi të aeroplanit: aktivizohet plani i reagimit për emergjencë në aksidente ose në incidente .

#### **VIII.2. Detyrat dhe Roli i Komitetit për Reagim Emergjent**

- Aktivizimi i Planit sipas skemës organizative
- Veprimi i menjëhershëm ndaj situatës emergjente
- Grumbullimi i të gjitha informatave nga përgjegjësi për incident, shqyrtimi i tyre dhe vendimmarrja për veprimet emergjente
- Vendorsja për drejtimin e operacioneve, si dhe mbajtja e kontaktit me subjektet relevante të pushtetit lokal
- Caktimi i zyrtarit përgjegjës për informim i cili do të mbaj kontakte me mediat dhe publikun.

### VIII.2.1. Agjencitë dhe organizatat të aktivizuara në përballimin e fatkeqësive

Tabela:

Funkcionet dhe aktiviteti në përballimin e fatkeqësive	Agjencitë dhe organizatat (shoqëria civile), me përgjegjësi ose të aktivizuara në përballimin e fatkeqësive										
	Komiteti i Reagimit Emergjent	Policia e Kosovës	SHEM – (Shërbimi Emergjent Mjekësor	Komisioni Emergjent	Degët e OJQ- ve	Ujësjetësi	K.K. i Kaçanikut	Biznesi privat	Shoqata e taxive	Mediat Lokale	Nj/ZSh– Kaçanik
Agjencia udhëheqëse në evakuim	x	x	x				x				x
Bashkëpunimi me qëllim të përballimit të fatkeqësive	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	
Drejtimi i evakuimit gjatë emergjencës	x	x	x								x
Drejtimi i operacioneve në kërkim shpëtim	x	x									
Pastrimi, riparimi i rrugëve dhe infrastrukturës tjetër		x			x	x	x	x	x		x
Kontrolli i sigurisë dhe trafiku	x	x									
Trajtimi i viktimave		x	x				x				
Vlerësimi i dëmeve	x			x							
Mbledhja e informacioneve për vlerësim	x	x		x	x						
Evidentimi i rasteve emergjente	x	x		x	x		x			x	x
Furnizimi me ujë dhe gjëra ushqimore					x	x	x	x			x


## VIII.2.2. KOMITETI I REAGIMIT EMERGJENT NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

Tabela:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendi i punës	Telefoni	Nënshkrimi
1.	<b>Besim Ilazi</b>	Kryetar i Komunës	044-116-133	
2.	<b>Ylber Bajra</b>	Nënkryetar i Komunës	044/118-667	
3	<b>Ramadush Osmani</b>	Drejtor i DESHP - së	044/414-303	
4	<b>Kemal Murseli</b>	Kryetar i Kuvendit	044/323-947	
5	<b>Diana Bajrami</b>	Drejtor i DSHMS-së	044/544-541	
6	<b>Bahri Selimi</b>	Drejtor i Financave	044/143-377	
7	<b>Ukshin Çollaku</b>	Drejtor i Urbanizmit	044/173-052	
8	<b>Festim Neziraj</b>	Drejtor i Administratës	044/711-610	
9	<b>Izahir Doda</b>	Drejtor për Arsim dhe Kulturë	044/225-351	
10	<b>Fatmir Loku</b>	Drejtor i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	044/227-959	
11	<b>Bujar Bajra</b>	Zyrtar për alarmim dhe koordinim emergjent	044/183-217	
12	<b>Ylber Shehu</b>	Shef i NJPZSH	044-224-812 044-228-228	
13	<b>Halim Shehu</b>	Komandant i Policisë	044/219-530	
14	<b>Sinan Zeneli</b>	Drejtor i QKMF- së	044/149-640	
15	<b>Naim Hysa</b>	Sekretarë i Kryqit të Kuq dega Kaçanik	044/224-881	
16				

## IX. MENAXHIMI I RESURSEVE GJATË NJË INCIDENTI

Figura : Menaxhimi i resurseve gjatë një incidenti



### IX.1. Identifikimi i nevojave

Kur ndodh një incident, ata që bartin përgjegjësi të menaxhimit të resurseve duhet vazhdimisht të identifikojnë, përmirësojnë dhe vërtetojnë kërkesat e resurseve.

Në resurset për tu identifikuar, në këtë mënyrë përfshihen pajisjet, furnizimet, shërbimet dhe personeli apo ekipet e reagimit emergjent.

Në rrethanat kur një incident është i projektuar të ketë implikime katastrofike (si: shtrëngatë; apo përmbajtje e madhe), qeveria dhe degët e saj regjionale mund t'i parapozicionojnë resurset në zonën e parashikuar të incidentit

### IX.2. Porositja dhe sigurimi

Kërkesat për resurset që nuk mund të sigurohen në nivel lokal, dorëzohen duke përdor procedurë standarde për porositjen e resurseve. Kryesisht këto kërkesa së pari dërgohen tek një lokalitet fqinjë apo në regjion e pastaj në qendër.

### IX.3. Përcjellja dhe raportimi

Përcjellja e resurseve është proces standard i integruar i zhvilluar para, gjatë dhe pas një incidenti nga i gjithë personeli i menaxhimit/reagimit emergjent dhe organizatat e tyre përkatëse.

#### **IX.4. Mobilizimi**

Personeli i menaxhimit/reagimit emergjent fillon mobilizimin kur njoftohet përmes kanaleve të caktuara zyrtare. Në kohën e njoftimit ata japin datën, kohën dhe vendin ku duhet shkuar, mënyrën transportimit për në incident, kohën dhe datën e menduar për arritje.

#### **IX.5. Rimëkëmbja dhe demobilizimi**

Rimëkëmbja/riparimi, përfshinë sistemimin përfundimtar të resurseve, përfshirë edhe ato të vendosura në incident edhe ato në hapësira/objekte fikse. Gjatë këtij procesi, rehabilitohen resurset, rimbushen/furnizohen, shkarkohen dhe/apo kthehen prapa.

Mund të filloj në çdo pikë të një incidenti, por duhet të filloj sa më shpejtë që të jetë e mundur për të mundësuar llogaridhënie të mirëfilltë.

##### **IX.5.1. Resurset jo të harxhueshme**

Resurset jo të harxhueshme (personeli, automjetet e zjarrfikjes dhe pajisjet e qëndrueshme) llogariten plotësisht edhe gjatë incidentit edhe kur ato kthehen tek organizata që e ka siguruar.

##### **IX.5.2. Resurset e harxhueshme**

Resurset e harxhueshme, siç janë uji, ushqimi, karburantet dhe furnizimet tjera të përdorimit të njëhershëm, duhet të llogariten plotësisht. Organizata e menaxhimit të incidentit bartë kostot e resurseve të harxhueshme, sipas autorizimeve në marrëveshjet financiare të zbatuara nga organizmat e gatishmërisë.

#### **IX.6. Kompensimi**

Kompensimi afron mekanizëm për kompensimin e fondeve të shpenzuara për aktivitetet specifike për incidentin.

#### **IX.7. Inventarizimi**

Menaxhmenti i resurseve përdor sisteme të ndryshme të inventarizimit të resurseve për të bërë vlerësimin e disponueshmërisë së aseteve të siguruar përmes juridiksioneve. Organizmat e gatishmërisë duhet të inventarizojnë dhe mbajnë të dhëna aktuale mbi resurset e tyre të disponueshme.

##### **IX.7.1. Akreditimi/Nostrifikimi**

Procesi i akreditimit ngërthen në vete vlerësimin objektiv dhe dokumentimin e çertifikatës, licencës apo diplomës ekzistuese të një individi, nivelin e trajnimit dhe përvojës, dhe zotësinë apo aftësinë për t'i plotësuar standardet e pranuar kombëtare,

#### **IX.8. Porositja dhe sigurimi**

##### **IX.8.1. Personeli i komandës**

Në një strukturë të komandës së incidentit, personeli i komandës në mënyrë tipike përfshinë zyrtarin për informimin publik, zyrtarin për siguri dhe zyrtarin për ndërlidhje.

Me Planin e reagimit emergjent të komunës së Kaçanikut për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë e tjera nënkuptojmë përcaktimin e kapaciteteve dhe resurseve si dhe caktimin e përgjegjësive, proceset operative për të ndihmuar mbrojtjen e vendit nga rreziqet natyrore, teknologjike të shkaktuara nga faktori njeri; shpëtimin e jetëve; mbrojtjen e shëndetit publik, sigurinë, të mirat materiale dhe mjedisin.

## MËNYRA E HARTIMIT TË DOKUMENTIT

Me propozim të Drejtorisë së Emergjencës dhe Shërbimeve Publike, si dhe në bazë të Vendimit të kryetarit të komunës z. Besim Ilazi 01Nr.104/02-13638/19 të dt.06.05.2019 për themelimin e grupit punues për përgatitjen e akteve komunale për situata emergjente, grupi punues në përbërje:

1. Bujar Bajra zyrtar për alarmim dhe koordinim emergjent, Koordinator i grupit
2. Ylber Shehu shefi NjPZSH -së,
3. Naser Kuka inspektor i mbrojtjes nga zjarri,
4. Nebi Murseli zyrtar i emergjencave

Duke u bazuar në ligjin Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri, Ligji Nr. 04/-L-049 për Zjarrëfikje dhe Shpëtim, si dhe Rregullorja Nr. 08/2013 për Përmbajtjen dhe Procedurat e Hartimit të Planeve të Reagimit Emergjent ka bërë hartimin e planit të reagimit emergjent për komunën e Kaçanikut,

**Vërejtje:** Ky plan është i aplikueshëm dhe funksional vetëm nëse bëhet njoftimi dhe trajnimi i personave përgjegjës të cilët do të caktohen dhe autorizohen për kryerjen e detyrave të veta në raste emergjente.

Drejtori i DESHP

z. Ramadush Osmani



Kryetari

z. Besim Ilazi

## **Akronimet**

**AME-** Agjencioni i menaxhimit të emergjencave

**FSK-** Forcat e sigurisë së Kosovës

**NJPZSh** – Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit

**PKI-** Post komanda e incidentit

**ZAKE-** Zyra për Alarmim dhe Koordinim Emergjent

**KI-** Komandanti i Incidentit

**QKMF-** Qendra kryesore e mjekësisë familjare

**QMF-** Qendra e mjekësisë familjare

**PTK-** Posttelekomi i Kosovës

**DSHPE-** Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

**PK-** Policia e Kosovës

**KKMSH-** Komiteti komunal për mbrojtje dhe shpëtim

**QOAKE-** Qendra Operative për Alarmim dhe Koordinim Emergjent

**OJQ-** Organizatat joqeveritare

